



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 325 Prot.

Tiranë, më 16.02.2017

VENDIM

Nr. 30, datë 16/2/2017

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e Informimit", shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, ligjin nr.10279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative", Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

V Ë R E N:

Ankuesi/ Qendra "Res Publica", përfaqësuar nga Z. _____, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit ankesën nr. 1339 datë 25.11.2016 me objekt, "*Ankim për refuzimin ndaj dhënies së informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare*", ndaj autoritetit publik/Drejtoria e Përgjithshme Detare.

Qendra "Res Publica", në cilësinë e kërkuarit me shkresat e datës 12.10.2016, ka kërkuar t'i vihet në dispozicion dokumentacioni si më poshtë:

Në lidhje me shkresën nr.116/16prot:

- 1. Cilat janë shërbimet që autoriteti publik i jep publikut, përfshirë dhe standartet për cilësinë e shërbimit;*
- 2. Një përshkrim të thjeshtë të sistemit që përdor autoriteti publik për mbajtjen e dokumentacionit, të llojeve, formave të dokumenteve, si dhe të kategorive të informacionit që bëhet publik pa kërkesë;*
- 3. Cilat janë mekanizmat apo procedura, përmes së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre apo të ndikojnë në çfarëdo mënyre tjetër në hartimin e ligjeve, të politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të autoritetit publik;*
- 4. Një përshkrim të kategorive dhe formave të ndihmës shoqërore, subvencioneve të dhëna nga autoriteti publik dhe të procedurave për t'i përfituar ato;*
- 5. Të dhëna për vendndodhjen e zyrave të autoritetit publik, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinatorsit për të drejtën e informimit.*

Në lidhje me shkresën nr.117/16prot:

- 1. Kopje të strukturës organizative;*
- 2. Të dhëna për arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve, të cilët kanë*

detyrimin për deklarimin e pasurisë sipas ligjit;

3. *Kopje të strukturave të pagave për nëpunësit e tjerë;*
4. *Kopje të Rregullores së Brendshme të institucionit.*

Në lidhje me shkresën nr.118/16prot:

1. *Kopje të planeve strategjike të punës;*
2. *Kopje të buxhetit për vitin 2015-2016;*
3. *Kopje të planit të shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe për vitet e kaluara për periudhën 2014-2016;*
4. *Kopje të dokumenteve që përmbajnë tregues të performacës së autoritetit;*
5. *Cilat janë mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi autoritetin publik;*
6. *Kopje të raporteve të auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose nga subjekte të tjera;*
7. *Informacion për procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese të koncesionit/partneritetit publik privat, që kryhen për llogari të autoritetit publik, duke përfshirë: listën e kontratave të lidhura; shumën e kontraktuar; palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve apo mallrave të kontraktuara;*
8. *Cilat janë mekanizmat për zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme.*

Në lidhje me shkresën nr.119/16prot:

1. *Sa është numri i kërkesave dhe përgjigjeve që i janë bërë autoritetit publik në kuadër të ligjit për të drejtën e informimit për vitin 2016 duke vendosur në dispozicion një kopje të të gjitha përgjigjeve që i është dhënë subjektit kërkuar;*
2. *Cilat janë informacionet dhe dokumentat që kërkohen më shpesh në institucionin tuaj.*

Ankuesi pretendon se është cënuar në të drejtën për informim, pasi nuk është informuar lidhur me sa ka kërkuar dhe për këtë arsye ka depozituar ankim pranë Zyrës së Komisionerit.

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, Komisioneri pas vlerësimit të ankesës, me urdhrin nr. 265 Prot, datë 15.12.2016, ka urdhëruar kryerjen e inspektimit administrativ pranë Autoritetit Publik/ Drejtorisë së Përgjithshme Detare.

Gjatë inspektimit është konstatuar se kërkesa e Qendrës "Res Publica" është depozituar pranë Drejtorisë së Përgjithshme Detare dhe është regjistruar me nr.426 Prot., datë 17.10.2016.

Pas kontaktit me zyrën e protokollit, nga ana e specialistes pranë Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse na u sqarua se: *shkresa përcjellëse e Qendrës "Res Publica", bashkëlidhur kërkesat: nr 116/16 Prot., 117/16 Prot., 118/16 Prot., 119/16 Prot., datë 12.10.2016, është depozituar pranë Drejtorisë së Përgjithshme Detare dhe është regjistruar me nr. 426 Prot., datë 17.10.2016. Kjo shkresë i ka kaluar Drejtorit të Përgjithshëm, Z. _____ dhe nuk i është sigluar për trajtim asnjë punonjësi të institucionit.*

Lidhur me ankesën e Qendrës "Res Publica", u kërkua të kontaktohej me Drejtorin e Përgjithshëm, për të bërë sqarimet përkatëse. Z. _____ nuk ndodhej në institucion në momentin e kryerjes së inspektimit.

Nga ana e grupit të inspektimit u konstatua se Autoriteti Publik/ Drejtoria e Përgjithshme Detare nuk i ka kthyer përgjigje kërkesës së Qendrës "Res Publica" të datës 12.10.2016.

Gjithashtu, u konstatua se Drejtoria e Përgjithshme Detare nuk ka përmbushur detyrimet e përcaktuara në nenet 4, 8 dhe 10 të Ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”. Bazuar në nenin 4 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, çdo Autoriteti Publik, jo më vonë se 6 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji ose nga krijimi i tij, vë në zbatim një program institucional të transparencës, ku përcaktohen kategoritë e informacionit që bëhet publik pa kërkesë dhe mënyra e bërjes publike të këtij informacioni. Ndërsa bazuar në nenin 8 të Ligjit 119/2014, Autoriteti publik krijon, mban dhe bën publik një regjistër të posaçëm, ku pasqyrohen të gjitha kërkesat për informim dhe informacionet e dhëna në përgjigje të tyre.

Gjatë inspektimit u parashtruan faktet dhe u përpilua procesverbali, i cili u firmos pa vërejtje nga ana e specialistes pranë Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse.

Pas shqyrtimit të ankesës, inspektimit, si dhe pas konsultimit të legjislacionit përkatës rezultoi se, informacioni i kërkuar nga Qendra “Res Publica”, përbën informacion publik. Në kuptim të pikës 2, të nenit 2, të Ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, *“informacion publik” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik”*.

Duke qenë se kërkesat e Qendrës “Res Publica”, përbëjnë informacion publik, bazuar në nenin 7 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, ato duhet të jenë të publikuara në Programin e Transparencës së Autoritetit Publik/Drejtoria e Përgjithshme Detare.

Bazuar në nenin 15 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Autoriteti Publik trajton kërkesën për informim brenda 10 ditëve pune nga data e dorëzimit të saj. Në çdo rast, mostrajtimi i kërkesës brenda këtij afati konsiderohet refuzim dhe bazuar në nenin 18, pika 2 a) e ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” përbën shkelje administrative .

Nga inspektimi rezultoi se Autoriteti Publik/Drejtoria e Përgjithshme Detare, nuk e ka trajtuar kërkesën për informim brenda 10 ditëve pune nga data e dorëzimit të saj, vërtetuar kjo nga zyra e protokollit të institucionit. Bazuar në nenin 10 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, me qëllim bashkërendimin e punës për garantimin e së drejtës së informimit, autoriteti publik cakton një prej nëpunësve si koordinator për të drejtën e informimit.

Autoriteti Publik/ Drejtoria e Përgjithshme Detare nuk ka caktuar koordinator për të drejtën e informimit nga autoriteti publik, gjë që prezumon se kompetencat e koordinitorit, përmbushen nga titullari i institucionit.

Pas shqyrtimit në tërësi të provave të administruara, Komisioneri konstaton se shkelja e kryer është mos trajtimi i kërkesës brenda afatit të parashikuar në ligj, e provuar kjo jo vetëm nga pretendimet e ankuesit në ankesë, por edhe nga konstatimi i grupit të inspektimit në zyrat e Autoritetit Publik/ Drejtoria e Përgjithshme Detare.

Bazuar në pikën 4 të nenit 15 të këtij ligji mos trajtimi i kërkesës konsiderohet *“refuzim”*. Bazuar në shkronjën “a” të pikës 2 të nenit 18 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, *“Refuzimi i dhënies së informacionit, në kundërshtim me parashikimet e këtij ligji, dënohet me 150 000 deri në 300 000 lekë”*.

Në zbatim të pikës 3 të nenit 19, përgjegjësia për këtë kundërvajtje administrative është e titullarit të institucionit, i cili ka përgjegjësi administrative për mostrajtimin e kërkesës brenda

afatit ligjor, në rastin konkret Z. , Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme Detare. Në këto kushte, kur provohet mos trajtimi i kërkesës brenda afatit të parashikuar në ligj, ky mosveprim konsiderohet kundërvajtje administrative dhe në bazë të nenit 18 pika 2 gërma "a" sanksionohet me gjobë.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjën a) të pikës 2 të nenit 18, pikën 3 të nenit 18, pikën 3 të nenit 19, pikat 1 dhe 2 të nenit 21, nenin 22, shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", ligjin nr.10279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative", shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr 49/2012 'Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative', i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës së Qendrës "Res Publica", nr. 1339 Prot., datë 25.11.2016 kundër Autoritetit Publik/ Drejtoria e Përgjithshme Detare, me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare".
2. Urdhërimin e autoritetit publik/ Drejtoria e Përgjithshme Detare, për vënien në dispozicion të ankuesit, dokumentacionin e kërkuar (shkresat: nr 116/16 Prot., 117/16 Prot., 118/16 Prot., 119/16 Prot., datë 12.10.2016).
3. Dënimin e Z. me gjobë në vlerën 150.000 (një qind e pesëdhjetë mijë) lekë për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 19, pika 4 . Masa e dënimit me gjobë, shlyhet me këste mujore. Gjoha ekzekutohet nga zyra e financës së Drejtorisë së Përgjithshme Detare brenda 6 muajve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Kundër vendimmarrjes në pikat 1 dhe 2, palët kanë të drejtën e ankimit brenda 45 ditëve në Gjykatën Administrative Tiranë, në përputhje me nenin 25 të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit".
5. Kundër vendimmarrjes në pikën 3, personi ndaj të cilit është vendosur sanksioni administrativ ka të drejtën e ankimit brenda 30 ditëve në Gjykatën Administrative Tiranë, në përputhje me nenin 22 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit".
6. Ky vendim u dha sot në datë 16.2 .2017.

